



Platforma programore për drejtimin e Universitetit të Prishtinës Tetor 2024 – Shtator 2028

Prof.Dr. Sefer Avdiaj



Short CV

- 2001 - Bsc** - Univeristy of Prishtina. Department of Physics
Supervisor: Prof. Rasim Bejtullahu.
- 2012 - PhD** - Jozef Stefan International Postgraduate School
Supervisor: Prof. Janez Setina
- 2016 - Guest Researecher** - Physikalisch Technische Bundesanstalt (PTB) – Berlin, June-July, 2016.
Supervisor: Dr. Karl Jousten
- 2016 - Guest Researecher** - Physikalisch Technische Bundesanstalt (PTB) – Berlin, July-August, 2016.
Supervisor: Dr. Karl Jousten.
- 2018 - Visiting Scholar** - National Institute of Standards and Technology – NIST (Gaithersburg - USA)
Supervisor: Dr. Jay Hendricks.
- 2022 – anëtar i Komitetit Teknik TC 16 ne IMEKO (International Metrology Confederation).
<https://www.imeko.org/index.php/tc16-homepage/tc16-members/1321-prof-avdiaj-sefer>

Scholarships

Fulbright shcolar, March 2018 – August 2018 (NIST)
DAAD award – 2014.

Scietic data:

Scopus **h** – **8**

Citime – **137**

Papers - **16**

<https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=36704376000>



“misioni i një universiteti nuk është thjesht transmetimi i dijës, por edhe krijimi i dijës”

"the mission of a university is not simply the transfer of knowledge, but also the creation of knowledge",



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 1: Digjitalizimi i shërbimeve dhe shpenzimeve

Administrata e UP-së nuk është duke funksionuar siç duhet, në shumë raste ka burokraci të panevojshme.

Prandaj kërkohet që shërbimet të digjitalizohen. Digjitalizimi do të bëhet në ngjashmëri me platformën e-kosova, (dokumente me vule elektronike) pra dokumentet e nevojshme për studentë të nxirren nga vetë studentët – i realizuar.

Të gjitha programet, qoftë të kaluara, qoftë këto aktuale të digjitalizohen.

D.m.th., nëse një person, qoftë ish-student, qoftë student aktual, ka nevojë ta ketë programin e tij të studimit do të ketë mundësinë ta shkarkojë personalisht nga llogaria e tij në SEMS.

Çertifikatat e notave dhe dokumente të tjera të ketë mundësi të shkarkohen nga SEMS-i personal i studentit me mundësi të vendosjes edhe të një studentmat në hapësirat e fakultetit përkatës. – i realizuar

- thjeshtzim i procedurave e monitorim (transparentë) më adekuat i financimeve të: vizatave, pjesëmarrjeve në konferenca. . . – përmes aplikimit të sistemi me kartela bankare , ku bartja e mjeteve e monitorimi (verifikimi i shpenzimeve) është i drejtëpërdrejtë.





Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 2:

Krijimi i shkollës doktrale, puna kërkimore-shkencore në UP

Arsyeja e problemeve të studimeve të doktoratës në UP – Manuali i riakreditimit,

Vetëm 5 programe në gjithë UP-në,

Rrezik në kalim në nivel kolegji,

Si të zgjidhim – përmes krijimit të shkollës doktrale,

Gjuha e programeve doktrale – gjuha angleze, përveç programeve që lidhen me fushën e albanologjisë.

Joint-Degree me universitete nga vendet e EU-së.

(Në mbështetje të këtij objektiv është edhe draftstrategjia e arsimit të publikuar nga MASHTI, në këtë draftstrategji është paraparë ofrimi i granteve për të inkurajuar dhe mbështetur projekte të përbashkëta për programe ndërdisiplinare).

Ekspertët e jashtëm kanë dhënë vërejtje për mungesën e buxhetit specifik për programe të caktuara në doktoratë dhe për mungesë laboratorësh (të ketë marrëveshje bashkëpunimi me universitete të EU-së për të parë se ku mund të kryhet pjesa eksperimentale e hulumtimit). Funksonimi me efektiv i shkollës doktrale - kryetari i Këshillit të doktoratës në nivel fakulteti, me automatizëm të jetë anëtar i Këshillit të doktoratës në nivel universiteti.

Qasja në revista shkencore - abonimi në revista shkencore relevante.

(Në draftstrategjinë e Arsimit 2022-2026, e cila tashmë është publikuar nga MASHTI, është paraparë që MASHTI do të sigurojë abonimet e stafit akademik në biblioteka ndërkombëtare elektronike).



Springer



Taylor & Francis
Taylor & Francis Group



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 3:

Paketa e instrumenteve të cilësisë (çështje që lidhen me procesin e akreditimit)

Mungesa e instrumenteve matëse që duhet plotësuar gjatë procesit të akreditimit:

Vlerësimi i studentëve për lëndën dhe mësimdhënësin (obligativ)

Vlerësimi ndërkolegial,

Vlerësimi nga dekani,

Vlerësimi i programeve studimore nga studentët,

Vlerësimi i programave studimore nga të diplomuarit,

Vlerësimi për dekanin nga ana e stafit akademik,

Vlerësimi i stafit akademik për gjendjen në fakultet/ universitet,

Vlerësimi i stafit administrativ për gjendjen në fakultet/ universitet,

Vlerësimi nga bordet këshilldhënëse për gjendjen në fakultet/ universitet,

Vetëvlerësimi i rezultateve të lëndës nga mësimdhënësi përkatës.

Probleme tjera:

Kohëzgjatja e studimeve më shumë sesa dyfishi i kohës (*kriter që duhet eliminuar*),

Hapja e programeve të reja të cilat kërkohen nga tregu i punës është po ashtu çështje me rëndësi. Me qëllim të tërheqjes së studentëve nga jashtë, programet e reja master që hapen të jenë në gjuhën angleze.

Programe të cilat janë unike në regjion për të tërhequr edhe studente nga regjioni, p.sh. Drejtësia Tranzicionale dhe të Drejtat e Njeriut,
Siguria Kibernetike dhe Sigurimi i Informacionit



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 4:

Përmirësimi i Kërkimeve, Projekteve dhe Inovacionit

Zgjerimi i Financimit dhe Mbështetjes për Kërkime

Kritja e Financimit për Projekte: Rritja e kufirit të financimit për projekte kërkimore akademike në 50,000 euro për projekt, ndarja e projekteve sipas meritokracisë.

UP si lider i arsimit të lartë në Kosovë duhet të jetë shumë më aktiv në aplikimin në projekte të EU-së dhe projekteve të tjera ndërkombëtare.

- Forcimi i Mbështetjes: Ofrimi i mbështetjes së plotë për studiuesit, përfshirë asistencën në shkrimin e granteve dhe ndihmën administrative. *Për të qenë kompetitiv dhe serioz në këto projekte, duhet që përveç zyrës qendrore ZKPS (Zyra për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara) të kemi edhe degët e saj nëpër fakultete dhe në kuadër të ZKPS të shtohet stafi me të paktën 7 persona, të cilët kanë ekspertizë në hartimin e projekteve me qëllim të konkurimit në projekte europiane dhe më gjerë.*

Nxitja e Inovacionit dhe Sipërmarrjes

Qendra e Inovacionit: Themelimi i një qendre inovacioni për të mbështetur startup-et dhe iniciativat sipërmarrëse, siç mund të jetë center for technology transfer or center for knowledge transfer.

Bashkëpunimi me Industrinë: Partneriteti me industrinë për të zhvilluar projekte kërkimore që kanë aplikime praktike dhe që mund të tërheqin fonde.

Qendrat e Ekselencës

Përmirësimi i Qendrave Ekzistuese: Investimi në qendrat aktuale të ekselencës për të zgjeruar fushëveprimin dhe ndikimin e tyre.

Qendra të Reja: Themelimi i qendrave të reja të fokusuar në fusha emergjente si inteligjenca artificiale dhe bioteknologjia.

- Stafi akademik i cili fiton projekte ndërkombëtare të lirohet nga 1/3 e ngarkesës në mësim.
- Në çdo njësi akademike, të krijohen grupet e ekselencës në hulumtim.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 5:

Shërbimet për shoqërinë dhe komunitetin – lidhja e kërkimeve shkencore me ekonominë dhe shoqërinë

Tregu i Kosovës ka shumë nevojë për një ekspertizë profesionale. Kush më mirë se personeli akademik i Universitetit të Prishtinës do ta ofronte këtë ekspertizë?

Me qëllim të gjenerimit të mjeteve vetanake dhe sigurisë në treg, duhet të krijohen hapësira për stafin e UP-së që dijen dhe ekspertizën e tyre ta përdorin brenda UP-së, me qëllim të zhvillimit të shoqërisë në përgjithësi.

Për këtë arsye, do të fillojmë me procedurat për **akreditim të laboratoreve** për testime dhe verifikime të produkteve të ndryshme, duke krijuar siguri në përdorimin e produkteve që janë në treg.

Përvoja e vendeve të Bashkimit Europian dhe atyre fqinje, kanë treguar se kjo është një mënyrë shumë e mirë që Universiteti të bëjë gjenerimin e mjeteve vetanake.

Eksplorimi i aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura, si **shërbimet këshilluese** dhe programet e trajnimit të specializuar.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 6:

Monitorimi dhe Vlerësimi

Matja e performancës së stafit akademik përmes kartelës së performancës

UP-ja tashmë ka filluar procesin për hartimin e rregullores për matjen e performancës së stafit akademik dhe është bërë një punë mjaft e mirë në këtë drejtim. Meqenëse isha pjesë e grupit punues për hartimin e kësaj rregulloreje, e njoh këtë proces në detaje. Ky proces duhet të vazhdojë që kjo rregullore të përfundohet brenda vitit 2024 dhe menjëherë në vitin 2025 të fillojë zbatimin e kësaj rregulloreje. Me qëllim të rritjes së performancës, do të ketë shpërblime për stafin akademik, i cili tregon performancë të mirë bazuar në kriteret e kësaj rregulloreje.

Një pikë me rëndësi do të jetë edhe pilotimi i projektit për vlerësimin e jashtëm të studentëve. Kjo bëhet për të krijuar një standard në vlerësim.

Do të krijohen mekanizma për shpërblime vjetore për hulumtuesit me të mirë të vitit.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 7: **Përzgjedhja dhe avancimi i stafit akademik në UP**

Me rastin e përzgjedhjes dhe avancimit të stafit akademik, secili person që aplikon, të bëjë një prezantim para një auditori në fakultetin përkatës, pra prezantimi të jetë obligativ.

Me qëllim të vlerësimit më të mirë, komisioni përkatës, rencensus, të jetë i obliguar të marrë pjesë në prezantimin e bërë nga kandidatët që konkurojnë.

Bazë e mirë e kriterëve për përzgjedhjen dhe avancimin e stafit është edhe rregullorja aktuale për procedurat përzgjedhese lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik si dhe **statuti i ri i UP-së**.

Problem që duhet theksuar është se aktualisht një punim i caktuar i një kandidati, merret në konsiderim vetëm nëse është autor i parë ose korrespondent.

Propozojmë që gjatë vlerësimit të punimeve shkencore të publikuara, të vlerësohet edhe bashkautorësia në punim.

7.1. Ftesa për kuadrot që kanë përfunduar studimet në vendet e BE-së dhe SHBA-ve.

Qysh në konkursin e parë nga marrja e detyrës, do të kërkohet nga dekanet e njësive akademike të UP-së, që të gjitha orët jashtë norme të deklarohen dhe të shpallet konkurs i ri për staf akademik. Do të kemi thirrje të veçantë për kuadrot nga diaspora shkencore shqiptare.



OBJEKTIVI 8: Mesimi Tutorial

Është rekomandim nga ekspertët e akreditimit!

Çka është mesimi tutorial?

Mësimi tutorial është një metodë e transferimit të njohurive dhe mund të përdoret si pjesë e një procesi mësimor.

Mësimi tutorial është më interaktiv dhe specifik sesa mësimi nga një libër ose nga leksionet.

Meqenëse mësimi tutorial bëhet në grupe të vogla, në këtë mënyrë krijohet mundësia e zgjidhjes së problemeve në ekip, si dhe zhvillohen aftësitë e studentëve për punë në grup.

Po ashtu, përmes mëimit tutorial, studentët marrin njohuri edhe nga njëri- tjetri për idetë e tyre, siç janë qasjet e ndryshme për të zgjidhur probleme të caktuara.

Pra, të futet mësimi tutorial, në programe, aty ku është e mundur.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 9: Decentralizimi i universitetit

Duke e ditur se Universiteti i Prishtinës është një institucion i madh, në shumë raste procedurat, si financiare ashtu edhe akademike, kërkojnë kohë shumë të gjatë në realizim.

Prandaj, do të ishte mirë të bëhet decentralizimi i Universitetit, pra të gjitha procedurat që janë të lejuara me ligj, të kalojnë në kompetencë të fakulteteve, si. p.sh. Blerjet në vlerë deri 10 mijë euro të jenë në kompetencë të fakulteteve.

Kështu do të delegohen përgjegjësitë aty ku zhvillohet pjesa më e madhe e punës së Universitetit dhe, besoj, do t'i minimizojmë mundësitë e abuzimeve që mund të sjellë koncentrimi tepër i madh i autorizimeve në duart e një numri të vogël të njerëzve.

Decentralizimi do të jetë shumë i dobishëm sidomos për disa fakultete të cilat janë shumë heterogjene në përbërjen e tyre.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 10: **Rritja e vizibilitetit të UP-së**

Meqenëse njëri nga faktorët në rangimin e universitetit është edhe vizibiliteti, përkatësisht klikueshmëria e ueb-faqes, duhet në mënyrë urgjente të funksionalizohet web-faqja në gjuhën angleze.

Çdo fakultet të ketë ueb-faqën e tij së paku në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe angleze.

Web-faqet e fakulteteve të jenë të menaxhueshme nga vetë fakultetet dhe jo nga zyra qendrore në rektorat.

Fakultetet të kenë të drejtë të kenë edhe ueb-faqet sipas dizajnit që dëshirojnë.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 11:

Plotësimi / Riformatimi i administratës

Ka disa vite që personat e pensionuar nga administrata e UP-së nuk janë zëvendësuar, prandaj ka mungesë të stafit në administratë.

Kjo mungesë në shumë raste shkakton mosfunksionim, sidomos çështja e laborantëve duhet të zgjidhet sa më shpejt – laborantët të jenë ndihmës të stafit akademik e jo pjesë e administratës.

Programet që lidhen me laboratore dhe punë praktike duhet të kenë patjetër laborantë si pjesë të tyre.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 12:

Lidhja e punës praktike me programet studimore

Rezultatet e deritanishme kanë treguar se studentët tanë gjatë studimeve në UP, kryesisht krijojnë dije teorike dhe pastaj kur dalin në tregun e punës kanë probleme që ta gjejnë vetën në punët reale.

Me qëllim që kjo dukuri të evitohet do të inicojmë idenë që në të gjitha lëndët-fushat ku kërkohet shkathtësi praktike, studentët të kryejnë pjesën praktike të asaj fushe, mundësisht çdo lëndë mësimore të ketë edhe pjesën praktike të saj.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 13: **Transparenca**

Të gjitha dokumentet e rëndësishme si dhe vendimet, të cilat merren në organet e UP-së do të publikohen ose do të jenë të qasshme për publikun e gjerë. Dokumentet aktualisht janë jo të kërkueshme nga web faqja.

Kështu, publiku do të mund të kontestojë saktësinë e të dhënave në një raport vlerësimi me rastin e pranimit të stafit akademik ose arsyeshmërinë e secilit vendim të organeve të Universitetit dhe të njësive akademike, si p.sh. vlerën e një punimi të masterit ose të doktoratës që mbrohet në Universitetin e Prishtinës.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 14:

Çështja e plagjiaturës dhe integritetit akademik

Çështja e plagjiaturës, fatkeqësisht është çështje aktuale shumë e përfolur në UP, duke filluar nga seminarët e studentëve, punimi i diplomës Bsc ose Msc e deri te punimet e doktoraturës.

Mund të konkludojmë se në shumicën e temave bachelor dhe në disa programe edhe në master, studentët nuk janë fare të informuar për problemet e plagjiaturës.

Për këtë arsye, në afat shumë të shkurtër do të fillohet me implementimin e kontrollit të të gjitha seminareve dhe temave të të gjitha niveleve, që punohen në UP, me anë të software-it antiplagjiat, pra një seminar apo temë, para se të pranohet, do të kontrollohet me këtë sistem.

Çdo temë që kalon pa e bërë testin e antiplagjiaturës do të anulohet.

Në mbështetje të këtij objektivi është edhe draftstrategjia e arsimit e publikuar nga MASHT-i, në të cilën po ashtu është paraparë të sigurohet kontrata aftagjate për shfrytëzimin e programeve antiplagjiaturë.

- qasje për stafin akademik dhe studentët në softver





Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 15:

Krijimi i një databaze për infrastrukturë në UP - Menaxhimi efektiv i pronës

Veprimet që parashihet të ndërmerren brenda këtij objekti janë rishikimi dhe azhurnimi i saktësisë së të dhënave të menaxhimit të aseteve, përfshirë verifikimin dhe përditësimin e të dhënave relevante dhe pronësinë e aseteve të paluajtshme të universitetit; krijimin e një platforme digjitale lehtë të përdorueshme për menaxhimin e aseteve të paluajtshme të universitetit.

Aktualisht UP-ja nuk posedon një databazë për të gjitha pajisjet për hulumtim që gjenden në departamente dhe fakultete të ndryshme në UP. P.sh. është e mundur që e njëjta pajisje ndodhet në disa vende. Të mos blihen pajisje të njëjta, të cilat i podeson UP-ja aktualisht.

- rregullore për qasje në platformën(at) instrumentale të aseteve të UP-së.



Po ashtu të shfrytëzohet gjithë hapësira e universitetit si një hapësirë e përbashkët për qëllime të akreditimit.

Problemi i FBV do të zgjidhet për vitin akademik 2025-2026



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 16:

Takimet me studentë “kafe dhe diskutim”

Universiteti egziston për studentët, prandaj do të mbahen takime me studentë së paku një herë në muaj për të parë shqetësimet dhe idetë e tyre në lidhje me zhvillimin e Universitetit.

Në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës, do të shihet mundësia që trafiku urban në Prishtinë për studentët e UP-së të jetë falas ose me një çmim maksimum 30% të biletës aktuale.

Do të trajtohet çështja e shtimit të hapësirave të leximit si dhe sallave ku mund të përdoren kompjuterët nga studentët.

Nëpërmjet këshillit botues, stafi akademik do të inkurajohet të përkthejë tekstet më të mira për të gjitha fushat, duke përkthyer të paktën një libër për program në vit.

OBJEKTIVI 17:

Lehtësime për stafin akademik dhe administrativ të UP-së

- Negocim me bankat për kushte më të favorshme të kredi-marrjes për stafin e UP-së (stabilitet i veçantë në aspektin e kontratave të punësimit si institucion kredibil – këtë problematike e rregullon edhe statuti i ri i UP-së.)
- Hapje (rishikim i hapësirave egzistuese, te Fakulteti Edukimit) të një çerdheje dhe hapësire të qëndrimit ditor për fëmijet e stafit akademik dhe administrativ të UP-së, me një kosto të volitshme. Praktika pedagogjike e studentët të fakulteteve, si p.sh. atij të Edukimit, programi parafillor, do të ishte mundësi e mirë për praktikë obligative profesionale (pedagogjike) dhe njëkohësisht të plotësojnë numrin e shumicës së punëtorëve të nevojshëm për operimin e kësaj çerdheje / qëndrimi ditor.
- Mundësi që stafi akademik edhe administrative të shfrytëzojnë për ushqim Mensën e Studentëve





Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

OBJEKTIVI 18:

Hartimi i strategjisë afatmesme për zhvillimin e Universitetit të Prishtinës

Nga fundi i vitit 2024, do ta kemi një Strategji 2025-2030 të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës. I bindur se kjo Strategji do të mund të përqendrohet në çështjet zhvillimore e jo në ato të karakterit emergjent. Ky dokument duhet të na tregojë se si e shohim Universitetin deri në vitin 2030, si të lidhim programet studimore me tregun e punës, si duhet të jemi më kompetitivë me universitete të vendeve të tjera, cilat disiplina akademike duhet t'i favorizojmë, si ta bëjmë më atraktiv Universitetin e Prishtinës për të rinjtë dhe si të nxisim edhe studentë nga vendet e rajonit apo më gjerë, të vijnë dhe të studiojnë në UP, si ta përmirësojmë infrastrukturën dhe, në përgjithësi, të krijojmë kushte për funksionimin normal të Universitetit.



Objektivat dhe kahet e veprimit për periudhën 2024 – 2028

Konkludim:

Pavarësisht se kush do të jetë rektor i Universitetit të Prishtinës, në vitet e ardhshme vëmendja duhet të përqendrohet në ndërtimin e një baze të shëndoshë për zhvillimin e Universitetit. Baza e shëndoshë nënkupton zbatimin e ligjeve, statutit dhe dokumenteve që vet UP-ja i ka krijuar. UP-ja ka një strategji 2023-2025, por kjo strategji është zbatuar jashtëzakonisht pak. Ftesa për kuadrot nga Diaspora dhe angazhimi i tyre në UP duhet të bëhet sa më parë në mënyrë që fryma e shkollës perëndimore të jetë më prezente në UP. Një qasje e tillë kërkon përkushtim dhe përgjegjësi të lartë nga të gjitha organet e Universitetit dhe njësitë akademike, e cila, shpresoj se nuk do të mungojë.



Faleminderit për
vëmendjen tuaj!

Thank you for your
attention!